REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
DPK/DMP 03
Nr. Prot. 03-3141/13
Data 02-10-2013
PRISHTINË

Nr. Regj. 18233/12

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, gjyqtaria Azra Cakolli me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Isa(Shukri)Kosumi, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 5.1 dhe 6.2 dhe neni 8 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050, e në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet(LK) GZ KSAK 23/79, më datë 30.09.2013 morri këtë:

**A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI: Isa(Shukri)Kosumi**, i lindur më 27.03.1961 në Tugjec Komuna e Kamenicës, me vendbanim të përkohshëm në Austri, Zëvendës Konsull në Ambasadën e Kosovës në Austri, magjistër i shkencave ekonomike, i martuar baba i tre fëmijëve,

**Ë sh t ë  p ë r gj e gj ë s**

Sepse si zyrtarë i lartë publik në pozitën e Zëvendës Konsullit në Ambasadën e Kosovës në Austri, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetorë të pasurisë, brenda afatit të paraparë ligjor gjer më 31 mars 2012, në Agjencinë Kundër Korrupsion, -

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5.1 dhe 6.2 dhe neni 8, ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050, andaj i shqipton:

**D Ë N I M**

**Më gjobë në shumë prej 1000(njëmijë)**, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. Pagesa bëhet në ndonjërën agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **30 ditësh.**
Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është e obliguar të paguaj shumën prej **5.€**, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje e këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

**A r s y e t i m**

**Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë**, i parashtroi kësaj gjykate kërkesën Nr. 01-1820/2012 me datë 22.05.2012 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj të pandehurit të lartcekur për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke propozuar të shpallet fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit.

03-3141/13/02



Gjyqtaria filloi procedurën me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2012 dhe atë më 31.03.2012 në ora 10:48 përmes postës elektronike në Ministrin e Punëve të Jashtme. Sipas mendimit të tij pika kontaktuese këtë formular nuk e ka dërguar me kohë në Agjencion, andaj ka vonesë dhe atë si që shkruan në Vërtetim me nr. protokollit 03/3608/12, pasuria është deklaruar më datë 12.08.2012, duke e prezantuar vërtetimin në shkresa të lëndës.
Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtaria ftoi Lumturie Lipovecin–zyrtare e lartë e personelit në MPJ-e, e cila u dëgjua në cilësi të dëshmitares e cila deklaroi se: Me kohë përmes i-malit e ka informuar zv. Konsullin Isa Kosumin për obligimin e deklarimit të pasurisë dhe ia ka dërguar sqarimet së bashku me formularët. Të gjitha i-mailet të kontaktimit i ka bashkëngjit në kopje dhe gjykatës ia dorëzon në shkresa të lëndës. Deklaron se është e vërtet se zv. Konsulli Isa Kosumi, formularin e ka dërguar në Ministri të Punëve të Jashtme, mirëpo ai ka qenë i informuar se formulari dërgohet personalisht ose përmes të personit të autorizuar nga ana e tij, në adresën agron.behrami @rks-gov.net. Në i-mail shihet çart se të gjithë Zyrtarët e lartë janë informuar për afatin prej datës 01.03 deri 31 03.2012 ku decidivisht thuhet se pasuria deklarohet në Agjencion kundër korrupsion. Poashtu prezanton korrespodencën elektronike me zv. Konsullin Isa Kosumin ku i ka bërë sqarimet lidhur me këtë. Deklaroi se në neni 4 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050, decidivisht janë të përcaktuar detyrat e pikës kontaktuese të institucionit, andaj konsideroi se i njëjti pasi që ka deklaruar edhe më herët dhe atë dy herë pasurinë ka pas mundësi të din se ky formular dorëzohet personalisht apo përmes personit të autorizuar nga ana e tij.
Gjyqtaria dëgjoi dhe Përfaqësuesin e Agjecionit kundër korrupsion Valbona Zeqirin, e cila deklaroi se pika kontaktuese për MPJ-e, Lumturie Lipoveci me kohë e ka dërguar Listën e Zyrtarëve të lartë në MPJ, ku gjendet edhe emri i zv. Konsullit Isa Kosomi. Deri më datën 31.03.2012 në Agjenci nuk ka arritur formulari për deklarimin e pasurisë për Isa Kosumi, andaj dhe kemi bërë kërkesë për inicimin e procedurës kundërvajtëse. Në Agjencion Isa Kosumi na ka sjell një kopje ku shihet se formularin e ka dërguar në MPJ-e, por i njëjti si që shihet edhe në vërtetim ka deklaruar pasurin më datë 13.08.2012 e jo si që gabim është shkruar në Vërtetim më datë 12.08.2012. Sipas Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050, pika kontaktuese ka obligim vetëm ta informon zyrtarin për obligim të deklarimit të pasurisë ndërsa zyrtari është i obliguar që vet apo përmes të ndonjë personi të autorizuar nga ai ta dorëzoj formularin e plotësuar në Agjencion kundër korrupsion. Konsideron se Isa Kosumi e ka kryer këtë kundërvajtje pasi që nuk ka respektuar afatin e fundit ligjor për deklarim të pasurisë.
Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimit të deklaratës së të pandehurit, deklaratës së Lumturie Lipovecit si Zyrtare e personelit në MPJ-e, e dëgjuar në cilësi të dëshmitares dhe deklaratës së përfaqësuesit të Agjencisë Kundër Korrupsion Valbona Zeqirit, nga korrespodenca elektronike me zv. Konsullin Isa Kosumi me Zyrtaren e lartë të personelit Lumturie Lipoveci, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: Ias Kosumi ka deklaruar pasurinë më datë 31.03.2012 në ora 10:48, por formularin e ka dërguar përmes postës elektronike në MPJ-e, e jo në Agjencionin Kundër Korrupsion, edhe pse ka pas informata të çarta se formulari dërgohet personalisht në Agjencion, përmes i-mail adresës së cekur në i-mail, të dërguar nga pika kontaktuese, apo ka pas mundësi ta dërgon përmes ndonjë personi të autorizuar nga ana e tij. Gjyqtaria sipas nenin 4 konsideron se në obligimin e pikës kontaktuese të institucionit, nuk qëndron si detyrë që ajo ta dërgon këtë formular në Agjencion, duke pas parasysh se është një çështje e ndjeshme e pasurisë personale dhe këtë çështje e ka rregulluar vetë ligji, ku thuhet se formularin duhet ta dorëzon personalisht apo përmes personit të autorizuar nga ana e tij. Poashtu gjyqtaria pati parasysh se kjo nuk është hera e parë që Isa Kosumi, deklaron pasurinë, pasi që ka bërë deklarimin dhe për vitin 2011, andaj konsideron se ka pas, apo është dashtë të ketë njohuri, kujt i dorëzohet formulari e posaçërisht kur shumë çart në i-mail ka pas sqarime kujt duhet ti dërgohet formulari si dhe adresa.

03-3141/13/03



Është cekur adresa e agron.behrami @rks-gov.net., andaj nga vlerësimi i shkresave të lëndës e posaçërisht nga administrimi i provave materiale të Lumturie Lipovecit–zyrtare e lartë e personelit në MPJ-e, gjyqtaria në mënyrë bindëse vërtetoi se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, për çka e shpalli përgjegjës dhe e dënoj me dënim minimal me gjobë të paraparë me ligj, ashtu si është cekur në dispozitiv të këtij aktvendimi.
Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LMK, nën të cilat është kryer kundërvajtja, peshën e veprës së kryer, personalitetin e të pandehurit si dhe shkallën e përgjegjësisë, me bindje se edhe me këtë dënimi do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Me sa u tha u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**
**DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE**
**Nr. Regj. 18233/12, datë 30.09.2013**

**Gjyqtaria**
**Azra Çakolli**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese **Gjykatës së Apelit-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë**, në afat prej **8 ditësh**, nga data e pranimit të njëjtit e nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.